

Në bazë të nenit 28 paragrafi (2), nenit 30 paragrafi (1) dhe nenit 45 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në përbërje prej: M-r Borçe Razmoski – Kryetar, M-r Malinka Siljanovska Nikoliq, Aleksandar Trgaçevski, Nikolla Trajçevski dhe Valon Elezi – anëtarë, duke vepruar sipas detyrës zyrtare kundër Shoqërisë për përpunimin dhe largimin e mbeturinave VEJSTER SHPKNJP Shkup, me seli në rr. „6” nr. 35 Trubarevë, Gazi Babë, e përfaqësuar nga Diana Katushevska – menaxhere, për vërtetimin e kundërvajtjes së kryer nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në seancën e mbajtur më datë 11.07.2025, e solli këtë:

### **AKTVENDIM**

1. Vërtetohet se duke vepruar sipas detyrës zyrtare kundër Shoqërisë për përpunimin dhe largimin e mbeturinave VEJSTER SHPKNJP Shkup, me seli në rr. „6” nr. 35 Trubarevë, Gazi Babë, e përfaqësuar nga Diana Katushevska – menaxhere, me NUAS 7433220 dhe numër unik tatimor: 4043020528791, xhiro-llogari nr. 210-0743322001-51 në NLB Banka Shkup, nuk ka vepruar sipas Konkluzionit për dorëzimin e të dhënave nr. 08-98 të datës 13.09.2023 të Komisionit brenda afatit të caktuar, e në kuptim të nenit 49 të Ligjit, në atë mënyrë që nuk i ka dorëzuar të dhënat e kërkuara me konkluzionin e theksuar brenda afatit të caktuar i cili ka skaduar më datë 29.11.2023, si ditë deri kur Shoqëria për përpunimin dhe largimin e mbeturinave VEJSTER SHPKNJP Shkup ka qenë e obliguar t’i dorëzojë të dhënat e kërkuara, por të dhënat e kërkuara i ka dorëzuar në rrugë elektronike më datë 26.12.2023 dhe me këtë ka kryer kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, për çka i shqiptohet sanksion – gjobë në vlerë prej 60.000,00 denarë, që paraqet 0,82642% nga vlera e të hyrave të përgjithshme vjetore të Shoqërisë për përpunimin dhe largimin e mbeturinave VEJSTER SHPKNJP Shkup të realizuara në vitin 2024, si viti i fundit afarist për të cilin e njëjta ka përpiluar llogari vjetore.

2. Gjobën nga pika 1) e këtij vendimi, kryerësit e kundërvajtjes janë të obliguar ta paguajnë brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit në llogarinë transaksionale të marrësit të pagesës: 100-0000000630-95, llogaria e pagesës: 840xxx07337 - gjoba për kundërvajtje të kryera nga fusha në kompetencë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, me shifrën e të hyrave 722139 dhe programin 00, marrësi i pagesës - Ministria e Financave, banka e marrësit – BPRMV dhe pranë Komisionit për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të dorëzojë dëshmi/kopje të pagesës së kryer të gjobës brenda afatit prej 15 ditësh nga kryerja e pagesës. Gjoba e papaguar ose e papaguar në kohë, do të inkasohet me forcë. Padia e shtyn ekzekutimin e vendimit.

### **Arsyetim**

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës me shkresën nr. 08-21 të datës 15.04.2024, deri te Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dorëzoi kërkesë për inicimin e procedurës kundërvajtëse.

Me kërkesën, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës kërkoi që Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të iniciojë procedurë sipas

detyrës zyrtare, midis tjerash edhe ndaj Shoqërisë për përpunimin dhe largimin e mbeturinave VEJSTER SHPKNJP Shkup-TRUBAREVË, me seli në rr. „6” nr. 35 Trubarevë, Gazi Babë me NUAS 7433220 dhe numër unik tatimor: 4043020528791 e përfaqësuar nga Diana Katushevska-menaxhere, për shkak të mosveprimit sipas konkluzionit nr. 08-98 të datës 13.09.2023 për dorëzimin e të dhënave brenda afatit të caktuar, e në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, që paraqet kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Më tej në kërkesë thuhet se Shoqëria VEJSTER SHPKNJP Shkup-TRUBAREVË pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës nuk i ka dorëzuar të dhënat e nevojshme në afatin ligjor prej 8 (tetë) ditësh nga dita e pranimin të konkluzionit nr. 08-98 të datës 13.09.2023, gjegjësisht nuk ka dorëzuar: Sasitë e përgjithshme të blera të mbeturinave të plastikës në vitin 2021 veçmas sipas furnizuesve, Sasitë e përgjithshme të blera të mbeturinave të plastikës në vitin 2022 veçmas sipas furnizuesve, Sasitë e përgjithshme të blera të mbeturinave të plastikës në gjysmën e parë të vitit 2023 veçmas sipas furnizuesve.

Qëllimi i sigurimit të të dhënave ka qenë që Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, si organ kompetent për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, të kryejë vlerësim të drejtë të njoftimit të dorëzuar për përqendrim midis KAPKA STAR RECYCLING SHPK, Umka Serbi dhe NUTRIVET SHPK Shkup, të cilët kanë pasur për qëllim të kryejnë bashkimin e biznesit për grumbullimin, transportin, magazinimin dhe trajtimin e mbeturinave jo të rrezikshme të NUTRIVET SHPK Shkup me biznesin e EKO STAR RECIKLAZHA SHPKNJP Shkup.

Për shkak të mosveprimit sipas konkluzionit 08-98 të datës 13.09.2023 për dorëzimin e të dhënave në afatin e caktuar, e në kuptim të nenit 49 të Ligjit, që paraqet kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit, me konkluzionin nr. 08-98 të datës 01.11.2023 e obligoi Shoqërinë VEJSTER SHPKNJP Shkup-TRUBAREVË, që deri te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës të dorëzojë të dhënat vijuese (brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e pranimin të konkluzionit):

-Sasitë e përgjithshme të blera të mbeturinave të letrës nga personat fizikë (grumbulluesit joformalë) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera/grumbulluara të mbeturinave të letrës nga subjektet juridike (krijuesit e mbeturinave) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera/grumbulluara të mbeturinave të letrës nga subjektet e tjera (të theksohet cilat) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera të mbeturinave të plastikës nga personat fizikë (grumbulluesit joformalë) nga territori i qytetit të Shkupit; - Sasitë e përgjithshme të blera/grumbulluara të mbeturinave të plastikës nga subjektet juridike (krijuesit e mbeturinave) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera/grumbulluara të mbeturinave të plastikës nga subjektet e tjera (të theksohet cilat) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera të mbeturinave të qelqit nga personat fizikë (grumbulluesit joformalë) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera/grumbulluara të mbeturinave të qelqit nga subjektet juridike (krijuesit e mbeturinave) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera/grumbulluara të qelqit nga subjektet e tjera (të theksohet cilat) nga territori i qytetit të Shkupit.

Në bazë të nenit 6, nenit 28 paragrafi (1), nenit 50 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikës 1 të Vendimit nr. 03-271/1 të datës 31.12.2018 të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, Komisioni solli Konkluzion për sigurimin e dëshmimeve në vendngjarje, me të cilin i urdhëroi Shoqërisë VEJSTER SHPKNJP Shkup – TRUBAREVË 6 35, Shkup, që personave të autorizuar nga Komisioni më datë 25.12.2023 në vendngjarje t’u sigurojë

dokumentacionin e nevojshëm. Më datë 25.12.2023 personat zyrtarë nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës përpiluan procesverbal nga kryerja e veprimeve nga neni 50 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në Shoqërinë VEJSTER SHPKNJP Shkup.

Shoqëria VEJSTER SHPKNJP Shkup konkluzionin nr. 08-98 të datës 13.09.2023 e ka pranuar më 21.11.2023, ndërsa ka vepruar sipas tij, gjegjësisht i ka dorëzuar të dhënat e kërkuara në rrugë elektronike, më datë 26.12.2023 (të protokolluara në Komision më 27.12.2023), edhe pse afati për dorëzimin e tyre ka skaduar më datë 29.11.2023.

Duke pasur parasysh faktin se VEJSTER SHPKNJP Shkup nuk ka vepruar në afatin e përcaktuar ligjor për përgjigje sipas Konkluzionit 08-98 të datës 13.09.2023, Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje, në seancën e mbajtur më datë 21.02.2025, solli Konkluzion për iniciimin e procedurës kundërvajtëse PK nr. 09-34/1 me të cilin kërkoi nga VEJSTER SHPKNJP Shkup t'i dorëzojë dokumentet vijuese: Certifikatë nga Regjistri Qendror për gjendjen aktuale; Bilancin e suksesit për vitin 2023 dhe të dhënat për xhiro-llogarinë, numrin unik tatimor dhe bankën deponente brenda 8 ditëve.

Konkluzioni është dorëzuar me shkresë përcjellëse PK nr. 09-34/2 të datës 21.02.2025.

Më datë 11.03.2025 me shkresën PK nr. 09-34/3, Shoqëria për përpunimin dhe largimin e mbeturinave VEJSTER SHPKNJP Shkup dorëzoi deklaram për Konkluzionin për iniciimin e procedurës kundërvajtëse dhe dorëzoi të dhënat dhe dokumentet e kërkuara.

Në përgjigjen e konkluzionit theksohet se arsyeja për të cilën shoqëria ka vonuar me veprimin sipas Konkluzionit nr. 08-98 të datës 13.09.2023 të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës është për shkak se menaxherja e shoqërisë së lartpërmendur ka qenë jashtë shtetit, gjegjësisht ka qenë në udhëtim në Indi, ndërsa pas kthimit nga udhëtimi është përballur me probleme shëndetësore për shkak të të cilave nuk ka mundur t'i kryejë obligimet e saj të punës në një periudhë prej 2-3 javësh.

Më tej, në shkresë theksohet se e njëjta pas kthimit në punë ka siguruar dokumentacionin e nevojshëm dhe ka vepruar sipas konkluzionit të Komisionit. Në shtojcë të deklaramit për konkluzionin e Komisionit për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, Shoqëria për përpunimin dhe largimin e mbeturinave VEJSTER SHPKNJP Shkup dorëzoi: Ekstrakt nga pasaporta për hyrje në Indi më 09.11.2023 dhe Vërtetim nga mjeku prej ISHP Sveta Elena.

Më datë 04.04.2025 KVK (Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje) solli Njoftim preliminar për gjendjen e vërtetuar faktike PK nr. 09-34/4.

Njoftimi preliminar për gjendjen e vërtetuar faktike PK nr. 09-34/4 është dorëzuar me shkresë përcjellëse PK nr. 09-34/5 më datë 07.04.2025.

Shoqëria për përpunimin dhe largimin e mbeturinave VEJSTER SHPKNJP Shkup nuk dorëzoi pranë KVK-së deklaram lidhur me Njoftimin preliminar për gjendjen e vërtetuar faktike PK nr. 09-34/4.

Më datë 30.05.2025, Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës solli Njoftim përfundimtar për gjendjen e vërtetuar faktike PK nr. 09-34/6.

Njoftimi preliminar për gjendjen e vërtetuar faktike PK nr. 09-34/4 është dorëzuar me shkresë përcjellëse PK nr. 09-34/5 më datë 07.04.2025.

Njoftimi përfundimtar për gjendjen e vërtetuar faktike PK nr. 09-34/6 është dorëzuar me shkresë përcjellëse PK nr. 09-34/7 më datë 30.05.2025.

Shoqëria për përpunimin dhe largimin e mbeturinave VEJSTER SHPKNJP Shkup nuk dorëzoi pranë KVK-së (Komisionit për Vendimmarrje pas Kundërvajtje) deklarim lidhur me Njoftimin përfundimtar për gjendjen e vërtetuar faktike PK nr. 09-34/6.

**Pas sigurimit të të dhënave të nevojshme me rëndësi për vendosjen e drejtë në procedurën kundërvajtëse dhe nga dëshmitë e mbledhura në vendngjarje, si dhe nga deklarimi pas njoftimit preliminar dhe përfundimtar për gjendjen e vërtetuar faktike të Shoqërisë për përpunimin dhe largimin e mbeturinave VEJSTER SHPKNJP Shkup, Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës vërtetoi se:**

Shoqëria për përpunimin dhe largimin e mbeturinave VEJSTER SHPKNJP Shkup nuk ka vepruar sipas Konkluzionit për dorëzimin e të dhënave nr. 08-98 të datës 13.09.2023 të Komisionit brenda afatit të caktuar, e në kuptim të nenit 49 të Ligjit, në atë mënyrë që nuk i ka dorëzuar të dhënat e kërkuara me konkluzionin e theksuar brenda afatit të caktuar i cili ka skaduar më datë 29.11.2023, si ditë deri kur Shoqëria për përpunimin dhe largimin e mbeturinave VEJSTER SHPKNJP Shkup ka qenë e obliguar t'i dorëzojë të dhënat e kërkuara, por të dhënat e kërkuara i ka dorëzuar në rrugë elektronike më datë 26.12.2023 dhe me këtë ka kryer kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Sipas nenit 61 paragrafi (1) të LMK (Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës), KVK-ja ndërmarrjes, gjegjësisht shoqatës së ndërmarrjeve, me vendim do t'i shqiptojë gjobë në vlerë deri në 1% të vlerës së të hyrave të përgjithshme vjetore të realizuara në vitin e fundit afarist, të shprehur në vlerë absolute dhe nominale, për të cilën ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjeve ka përpiluar llogari vjetore nëse:

-Nuk vepron sipas konkluzionit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës ose Komisionit për Vendimmarrje për Kundërvajtje për dorëzimin e të dhënave në afatin e caktuar, e në kuptim të nenit 40, nenit 48 dhe nenit 49 të këtij ligji.

Të hyrat e përgjithshme të Shoqërisë për përpunimin dhe largimin e mbeturinave VEJSTER SHPKNJP Shkup të realizuara në vitin 2024 arrijnë në 7.260.182,00 denarë.

Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës vërtetoi se shuma e gjobës që i shqiptohet Shoqërisë për përpunimin dhe largimin e mbeturinave VEJSTER SHPKNJP Shkup për kundërvajtjen e kryer nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës arrin në 60.000,00 denarë, që paraqet 0,82642% nga vlera e të hyrave të përgjithshme vjetore të Shoqërisë për përpunimin dhe largimin e mbeturinave VEJSTER SHPKNJP Shkup të realizuara në vitin 2024, si viti i fundit afarist për të cilin e njëjta ka përpiluar llogari vjetore.

Për shkak të gjithë të lartpërmendurave u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për inicimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente brenda afatit prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi. Padia e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS  
KOMISIONI PËR VENDIMMARRJE PËR KUNDËRVAJTJTE  
KRYETAR  
Mr. Борче Размоски**